



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.9.2023

Nr: 761

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**DELEGIMIN E KOMPETENCËS KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 11,  
BASHKIA KUKËS, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesve TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR  
ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETARIN E BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 6, pikat 1, 4 e 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8 të vendimit nr. 23, datë 1.2.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV, VNV, në zgjedhje”,

V E N D O S:

1. T’i delegojë Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, Bashkia Kukës, kompetencën për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 4.9.2023 Nr: 761  
Ora: 14:00



“Për delegimin e kompetencës KZAZ-së nr.11, Bashkia Kukës, për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”